ADING
pjesë përbërëse e çdo ndërtimi

FLUIDING

Plastifikues për beton dhe suva / ngadalësues i lidhjes
Përgjigjet në: EN 934-2:T2

ADITIVË PËR BETON

FUSHA E APLIKIMIT

Përgatitje e përzierjeve "standarde" të betonit të dedikuara për realizimin e pozicioneve të ndryshme te objektet ndërtimore (konstruksione të themeleve dhe të tjera nëntokësore, dysheme industriale, AB shtylla, direkë dhe konstruksione mes kateve, konstruksione betoni të rrugëve, objekte hidroteknike, murre mbështetëse e të tjera).
Përgatitje e përzierjeve të betonit të cilat janë të dedikuara për transport dhe vendosen me pompë;
Betonimi i elementeve ndërtimore me prerje të dendura me armaturë;
Përgatitje e përzierjeve injektuese të çimentos;
Përgatitje e betoneve ekonomike me raport optimal midis komponentëve dhe perfomancave të betonit;

CILËSI

- Mundëson reduktim të ujit deri më 15%;
- E përmirëson shkallën e përpunimit të betonit pa shtimin plus të ujit;
- E lehtëson vendosjen dhe e përmirëson kompaktësinë e betonit;
- E rrit mos-depërtueshmërinë të betonit ndaj ujit;
- I përmirëson karakteristikat fiziko-mekanike të betonit (karakteristika të rritura fillestare dhe përfundimtare të fortësisë);

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

CILËSI	METODË	VLERË E DEKLARUAR
Dukje	Vizuale	Lëng i kaftë
Masë volumi (në 20ºC)	ISO 758	(1.15±0.03) g/cm^3
Përmbajtje e kloridëve	EN 480-10	≤0,1%
Përmbajtje e alkaleve	EN 480-12	≤6,0%
pH vlerë (në 20ºC)	ISO 4316	7,5±1,0

Ading AD, Shkup, Adresë: Novoselski Pat (ul.1409) br.11, 1060 Shkup Republika Maqedoni
Tel.: +389 / 02 2034 840; fax: +389 / 02 2034 850;
e-mail: ading@ading.com.mk, www.ading.com.mk

ADITIVË PËR BETON

DOZIMI DHE PERFORMANCA:

Dozimi optimal i FLUIDING lëviz prej 0,4 deri 1,0% në raport me sasinë e çimentos në përzierjen e betonit. Në rast të dozimit të tillë arrihet reduktim i ujit deri 12% (Diagram 1). Me këtë rast, në mënyrë përkatëse arrihet rritje e karakteristikave të fortësisë së betonit (Diagram 2).



Diagram 1



Diagram 2

Beton referent I sipas EN 480-1 me përdorim të CEM I 42.5R

Dozimi optimal i FLUIDING më mirë përcaktohet me ekzaminime paraprake laboratorike ose industriale.
Në kushte të temperatura të larta ambientale ose në rast në rast kur prodhimi, transporti dhe vendosja e betonit zgjat më gjatë se 60 minuta, në përzierjen e betonit në vend FLUIDING, rekomandohet që të përdoret FLUIDING M ose FLUIDING M1M, ose në mënyrë shtesë të dozohet aditiv për ngadalësim të lidhjes së betonit USPORUVAÇ-D2.
Dozimi i aditivëve bëhet në mënyrë manuale ose automatikisht gjatë prodhimit të betonit. Efekti më i mirë arrihet kur FLUIDING shtohet bashkë me 20-30% nga uji i nevojshëm, në agregatin, çimenton dhe 80% të ujit paraprakisht të përzier. Kohëzgjatja e rekomanduar e përzierjes së betonit të freskët me shtimin e FLUIDING nuk duhet të zgjasë më pak se 90 sekonda.
Efekte nga tej-dozimi: Dozimi tejet i lartë i FLUIDING mund të shkaktojë segregacion (ndarje) të betonit, e mandej edhe humbje e shpejtë e përpunimit dhe fillimi i lidhjes së betonit.

KOMPATIBILITET

FLUIDING MS është kompatibil me të gjithë aditivët nga programi i ADING. Nëse në përzierjen e betonit përdoren dy ose më tepër aditivë nevojitet që të bëhen ekzaminime paraprake. Aditivët e ndryshëm dozohet veç e veç përkatësisht nuk përzihen mes vete para vënies në përzierjen e betonit. FLUIDING MS është i përdorshëm me të gjitha llojet e portland çimentos duke përfshirë edhe çimentot rezistuese ndaj sulfateve.

PAKETIMI

Kova plastike: 5 dhe 24 kg
Fuçi: 240 kg
Kontejnerë: 1200 kg

Ading AD, Shkup, Adresë: Novoselski Pat (ul.1409) br.11, 1060 Shkup Republika Maqedoni
Tel.: +389 / 02 2034 840; fax: +389 / 02 2034 850;
e-mail: ading@ading.com.mk, www.ading.com.mk

ADITIVË PËR BETON

VENDOSJE NË DEPO

Në paketim origjinal në temperaturë prej 5°C deri 35°C. Afati i përdorimi 12 muaj.

SHENJË PËR PRODHIM TË ÇERTIFIKUAR

CE **2032**
ADING AD Shkup **Novosellski pat (rruga 1409) nr. 11, 1060** **Shkup, Maqedoni** **08** **2032-CPR-08.40B** **EN 934-2:2009+A1:2012**
FLUIDING **Aditiv për beton, plastifikues** **EN 934-2:T2** **Përmbajtje maksimale e klor joneve: 0.1%** **Përmbajtje maksimale e alkaleve: 6.0%** **Veprim korroziv: I përmban komponentët vijuese nga EN 934-1:2008, Aneks A.2: Tiocijanitë**

Rrezik për jetën: Fluiding nuk përmban materie toksike, por edhe krahas kësaj nevojitet që të kihet kujdes që materiali të mos vijë në kontakt me lëkurën, sytë ose të gëlltitet. Në rast të kontaktit me lëkurë ose me sytë, nevojitet që menjëherë të shpëlahem me ujë rrjedhës. Nëse gëlltitet, nevojitet që të kërkohet ndihmë mjekësore. Informacione shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.
Zjarr: : Fluiding është lëng që nuk mund të ndizet. . Informacione shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.
Pastrimi dhe deponimi: Mbetjet e pa lidhura të Fluiding pastrohet me ujë. Ambalazhi i vjetër dhe i përdorur nevojitet të deponohen sipas dispozitave dhe regullativave lokale për këtë lloj të mbeturinave. Informacione shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit

Ading AD, Shkup, Adresë: Novoselski Pat (ul.1409) br.11, 1060 Shkup Republika Maqedoni
Tel.: +389 / 02 2034 840; fax: +389 / 02 2034 850;
e-mail: ading@ading.com.mk, www.ading.com.mk